

NEWSLETTER

Qershor

**Albsig, sërish në krye —
Besimi i klientëve kthehet
në performancë konkrete**

**Një ditë e dedikuar
argëtimit, bashkëpunimit
dhe frymës së ekipit**

**ALBSIG organizon një ditë
dhurimi gjaku në bashkëpunim
me Kryqin e Kuq Shqiptar
Kontribut i drejtpërdrejtë për
një çështje jetike në sistemin
shëndetësor**

**Zgjidhje të
dedikuara sigurimi
për çdo aspekt të
pushimeve tuaja**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 31 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA


Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



**Albsig, sërish në
krye — Besimi i
klientëve
kthehet në
performancë
konkrete**



Kur flitet për siguri, shpejtësi dhe mbështetje reale në momentet që kanë më shumë rëndësi, gjithnjë e më shumë qytetarë dhe biznese zgjedhin Albsig. Kjo reflektohet edhe në rezultatet më të fundit, ku kompania është renditur në vendin e parë për disa nga produktet më të rëndësishme në tregun e sigurimeve: KASKO, Përgjegjësia e Ndërtuesit, dhe Garancitë.

Pas këtij suksesi qëndron një punë e vazhdueshme dhe një filozofi shumë e qartë: të jemi aty për klientin, në kohën dhe mënyrën që ka më shumë rëndësi për të. Shpejtësia dhe efikasiteti në procesin e trajtimit të dëmeve kanë qenë faktor kyç për këtë performancë, jo thjesht si premtim, por si përvojë konkrete për të gjithë ata që kanë pasur nevojë për mbështetje në një moment të vështirë.



Ajo që e ka dalluar Albsig në këtë rrugëtim është aftësia për t'u përshtatur me kohën. Investimet në teknologji dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimit kanë bërë që çdo proces, nga sigurimi deri te dëmshpërblimi, të jetë më i thjeshtë, më transparent dhe më i shpejtë për klientin.

Përveç kësaj, prania në terren përmes rrjetit të degëve dhe agjentëve të shpërndarë në të gjithë Shqipërinë, e ka bërë edhe më të lehtë për qytetarët të marrin shërbimin që ju nevojitet, aty ku janë. Çdo paketë ofrohet me kujdes dhe fleksibilitet, sipas nevojave specifike që sjell tregu, një qasje që e bën Albsig një partner afatgjatë, jo thjesht një ofrues shërbimesh.

Ky pozicionim i fortë në treg është shumë më tepër se një arritje në numra, është konfirmim i besimit që klientët na japin çdo ditë, dhe një përgjegjësi që e marrim me seriozitetin më të madh: të mbetemi gjithmonë të parët në kujdes, në shërbim dhe në përkushtim.



Një ditë e dedikuar argëtimit, bashkëpunimit dhe frymës së ekipit!

Në kuadër të iniciativave për fuqizimin e kulturës organizative dhe ndërtimin e një ambienti pune më të bashkuar, Albsig organizoi një retreat të dedikuar për stafin, që u zhvillua në ambientet e Tropikal Resort, Durrës. Aktiviteti u konceptua si një ditë larg rutinës së përditshme, me fokus te bashkëpunimi, komunikimi ndërpersonal dhe vlerësimi i përbashkët i rrugëtimit të kompanisë.

Gjatë ditës, pjesëmarrësit morën pjesë në një sërë lojërash argëtuese dhe sfidash të ndërtuara sipas formatit team-building, të cilat synonin të forconin lidhjet mes kolegëve dhe të nxisnin një frymë të shëndetshme bashkëpunimi dhe kreativiteti. Nga sfidat individuale deri te aktivitetet në grup, çdo moment ishte një mundësi për të reflektuar mbi rëndësinë e punës në skuadër dhe komunikimit efektiv.

Një nga momentet më të veçanta të ditës ishte organizimi i një quiz-i mbi historikun dhe arritjet e Albsig, që shërbeu si një mënyrë interaktive për të kujtuar pikat kyçe të zhvillimit të kompanisë dhe për të nxitur ndjenjën e përkatësisë. Pyetjet përfshinin fakte historike, të dhëna rreth produkteve dhe nismave më të rëndësishme që kanë ndërtuar profilin e Albsig në tregun e sigurimeve.

Pjesëmarrja entuziaste dhe energjia pozitive e stafit konfirmuan edhe një herë rëndësinë e këtyre aktiviteteve për motivimin dhe angazhimin e brendshëm. Ky retreat nuk është thjesht një ditë argëtimi, por një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi rrugëtimin e përbashkët dhe për të forcuar më tej lidhjet që e bëjnë një ekip të suksesshëm. Aktivitete të tilla janë tashmë pjesë e kalendarit të përvitshëm të kompanisë dhe përfaqësojnë përkushtimin e Albsig për të ndërtuar një kulturë pune ku bashkëpunimi, mirëqenia dhe motivimi i stafit qëndrojnë në themel të çdo suksesi.






ALBSIG organizon një ditë dhurimi gjaku në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar

Kontribut i drejtpërdrejtë për një çështje jetike në sistemin shëndetësor

Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për përgjegjësi sociale dhe mbështetje ndaj komunitetit, ALBSIG organizoi në ambientet e drejtorisë qendrore një aktivitet dedikuar dhurimit vullnetar të gjakut, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar. Nën moton “Dhuro gjak, shpëto jetë”, punonjës të kompanisë u bënë pjesë aktive e një procesi jetik për sistemin shëndetësor në vend.

Dhurimi i gjakut është një ndër aktet më domethënëse të solidaritetit dhe një nevojë e vazhdueshme për trajtimin e pacientëve që përballen me emergjenca mjekësore, ndërhyrje kirurgjikale, apo sëmundje kronike.

Përmes kësaj iniciative, ALBSIG synon të përçojë mesazhin se secili prej nesh mund të bëjë një ndryshim të vërtetë në jetën e dikujt, me një akt të thjeshtë, por me ndikim të madh. Nisma është pjesë e kalendarit të veprimtarive të kompanisë që mbështetin kauza sociale dhe kontribuojnë në mirëqenien kolektive.



Ne e shohim përgjegjësinë sociale jo thjesht si pjesë të identitetit tonë korporativ, por si një detyrim moral për të qenë pranë komunitetit në momente dhe forma që kanë rëndësi reale.

Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar ka qenë thelbësor për realizimin e kësaj dite, duke siguruar standardet e duhura mjekësore, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e stafit në një atmosferë organizative shembullore.

ALBSIG mbetet e angazhuar për të vijuar mbështetjen e kauzave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës në shoqëri, duke fuqizuar rolin e saj si një kompani që kujdeset jo vetëm për sigurinë financiare, por edhe për jetën.





Zgjidhje të dedikuara sigurimi për çdo aspekt të pushimeve tuaja!

Koha ideale për të udhëtuar, për të eksploruar destinacione të reja apo për të shijuar qetësinë buzë detit. E ndërsa nisni pushimet, Albsig ju fton të mos lini pas dore sigurinë tuaj dhe të atyre që doni.

Me fushatën “A e sigurove verën tënde?”, Albsig sjell zgjidhje konkrete dhe të lehta për t’u aksesuar, që ju mundësojnë të shijoni verën pa shqetësime, me një gamë të gjerë produktesh sigurimi që adresojnë nevojat më të shpeshta të sezonit veror.

Sigurimi i shëndetit në udhëtim. Mbrojtje kudo që shkoni.

Udhëtimet jashtë vendit janë një pjesë e rëndësishme e verës, por situatat e paparashikuara mund të ndodhin në çdo moment. Polica e sigurimit të shëndetit në udhëtim nga Albsig ofron mbulim për urgjenca mjekësore, shpenzime spitalore dhe ndihmë në rastet e nevojës, duke u bërë një partner i besueshëm për pushime të qeta dhe të sigurta në çdo destinacion.

Sigurimi i banesës — Qetësi, edhe kur s’jeni në shtëpi

Ndërsa shumë familje zhvendosen për pushime, mbrojtja e banesës mbetet një prioritet. Sigurimi i banesës nga Albsig ofron mbrojtje ndaj zjarrit, fatkeqsive natyrore, rënie e mjetit fluturues, rrjedhje të tubacioneve dhe përgjegjësi ndaj palëve të treta, që ju të mund të lini pas çdo shqetësim dhe të fokusoheni vetëm në pushime.



ALBSIG

UDHËTIMI NIS ME **ENTUZIAZËM**
DHE ME NJË **SIGURIM** NË XHEP.



Sigurimi i biznesit — Mbështetje në sezonin më të ngarkuar.

Në kulmin e sezonit turistik, çdo ditë pune ka rëndësi. Për hotelet, baret, restorantet apo strukturat e tjera akomoduese, një ndërprerje për shkak të një incidenti mund të ketë pasoja të mëdha. Albsig ofron paketa të personalizuar sigurimi për subjektet në sektorin e hoteleri-turizmit, që mbulojnë dëmet nga zjarri, sigurimin e përgjegjësisë civile, sigurimin e enëve nën presion, si dhe rreziqet shtesë nga shkaqe natyrore.

Një zgjidhje e zgjuar për të mbajtur biznesin tuaj të mbrojtur, që aktiviteti të vijojë pa ndërprerje dhe me më shumë siguri.

Sigurimi online — Bli shpejt, thjesht dhe sigurt në albsig.al

Sigurimi juaj është vetëm një klik larg. Në albsig.al mund të blini lehtësisht të gjitha sigurimet e përmendura më sipër. Platforma është e aksesueshme 24/7 dhe ofron informacion të detajuar, kalkulim automatik të çmimit dhe përfundim të menjëhershëm të blerjes. Nuk ka më pritje, takime apo procedura të gjata, sigurohuni nga shtëpia ose gjatë rrugës për në pushime!

**Këtë verë zgjidh sigurinë,
sepse vera është për t'u shijuar,
pjesa tjetër është puna jonë.**


Bli Online

albsig.al



Mjafton një klik në albsig.al





 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL